



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.172/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR, dega në Gjilan, për shkak të vendosjes së posterave në shtylla publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, dhe koalicionit LDK-AKR, dega në Gjilan, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 2,700.00 (dymijeshtatëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 05.06.2017 ka pranuar një ankesë, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkëngjitur si dëshmi fotografitë e printuara nga vendi i ngjarjes. Parashtruesi i ankesës potencon se me datën 07.06.2017, në Rrugën “Idriz Seferi”, në Gjilan, monitoruesi i tyre ka hasur në postera të kandidatëve për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga koalicioni LDK-AKR, të ngjitur në shtylla publike.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga Koalicioni LDK-AKR është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33, paragrafi 1, pika b, e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073, sepse vendosja e posterave në shtylla publike përbën veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tijë. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkëngjitur dy fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë koalicioni LDK-AKR, të datës 09.06.2017, ka pranuar shkeljen pretenduar në ankesë duke arsyetuar se kanë urdhëruar kandidatin që të ndërmarr veprimet përmirësuese, dhe se koalicioni LDK-AKR pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së, ka ndërmarrë masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre kanë bashkëngjitur dy foto nga vendi ku janë larguar posterat.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli vlerëson se nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtuesi i ankesës të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e koalicionit LDK-AKR, janë vendosur në shtylla publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike* ”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstatoi se nga provat e ofertuar shihet qartë se nga ana e koalicionit LDK-AKR, është shkelur neni 33, pika b) të LZP-së pasi që njoftimi për mbajtje të tubimit elektoral, janë vendosur në shtylla publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni LDK-AKR, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se shkelja nga ana e këtij koalicioni është përsëritur disa herë në këtë proces zgjedhor, ku për kundër këtij fakti posterat e kandidatëve për deputet nga koalicioni LDK-AKR, janë vendosur në shtylla publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që se koalicionit, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që i kanë tërhequr posterat në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 172/2017 më datën 09.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.